

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Elife Uka, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Mervete Krasniqi në lëndën penale kundër të pandehurit Sh.S.për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378, par. 6, lidhur me par. 1, të KPRK. duke vendosur sipas aktakuzës PP.IInr.1202/2017, të dt. 05.04.2017,të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, pas mbajtjes të shqyrtimit kryesor në prezencën e Prokurorit të Shtetit, me dt. 15.03.2018, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit

Sh.S., I biri I F. dhe N., e gjinisë G., I lindur me ..., në fshatin M., K. O., ku edhe jeton, babe I ... fëmiu, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, me nr. personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 02.02.2017 rreth orës 12.30, në rrugën "A.V.", në P., i pandehuri Sh.A., deri sa ishte duke drejtuar automjetin e markës "Mercedes Daimler ML 270", ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., nga pahujdesia, duke menduar lehtë se nuk do të rrezikoj komunikacionin, nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit, duke rrezikuar jetën e njerëzve dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 149.1, të LSKRR-së, i cili ka qenë duke lëvizur nga lagja e E. në drejtim të rrethrotullimit "V." dhe me të arritur në vendkalim për këmbësor, duke mos e përshtatur mënyrën e lëvizjes ndaj kushteve të krijuara në rrugë, duke mos pasur kujdes të shtuar ndaj pjesmarrsve tjerë në komunikacion pasi që ka qenë rrugë urbane dhe vendkalim për këmbësorë, e ka goditur me pjesën e përparme ballore këmbësorin A.K., i cili ishte duke e kaluar rrugën në vendkalimin për këmbësorë, me ç'rast dëmtime të lehta trupore pëson i dëmtuari A.K. dhe shkakton aksident trafik.

Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378, par. 6, lidhur me par. 1, të KPRK.

Prandaj duke u bazuar ne dispozitat e nenit 3,50,51,52,53,73,74, 378, par. 6, lidhur me par. 1, të KPRK, nenit si dhe nenit 365, të KPPRK,i

G J Y K O N

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj e të cilin nuk do ta mbaj po që se i akuzuari në afat prej një (1) viti nuk do të kryej këtë vepër penale.

OBLIGOHET i pandehuri që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 66.88 €, kurse që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga 50 €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi e merr formën e prerë.

I dëmtuari A.K. për realizimin kërkes pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP.Ilnr.1202/2017, të dt. 05.04.2017,e ka akuzuar të pandehurin Sh.S.për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378, par. 6, lidhur me par. 1, të KPRK, dhe ka propozuar që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta denoj sipas ligjit.

I pandehuri Sh.S.në shqyrtimin kryesor në tersi e kanë pranuar fajësinë në kuptim të nenit 326, par. 1, të KPPRK, për veprën penale për të cilën e ngarkon Prokuroria e Shtetit, dhe se gjykata ka vlerësuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 248, par. 1, po të këtij kodi, përkatësisht vlerësoj se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe mbështetet në faktet dhe provat që mbështetin aktakuzën.

Gjatë matjes së dënimit gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform të nenit 73, të KPRK, ashtu që rrethana rënduese nuk gjeti, kurse si rrethanë lehtësuese ka marrë se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në seancën fillestare, se kishte sjellje korrekte, ka shprehur pendim të thellë, si dhe premtim se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin ashtu që gjykata e ka gjykuar me dënim të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të pandehurit rrezikshmërisë reale shoqërore të veprës penale, do të i shërbejë si preventivës individuale ashtu dhe gjenerale, do të parandaloj që në të ardhmen mos të kryejë vepra penale, do të bëjë rehabilitimin e tij si dhe do të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprës penale, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 42, e që mund të arrihet edhe pa ekzekutimi e tij.

Mbi kërkesën pasurore juridike është vendosur në konformë të nenit 463, par.2, të KPPRK-së.

Mbi shpenzimet e procedurës penale, është vendosur në konform të nenit 450, të KPPRK.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365, të KPPRK-së, u vendos i në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 1845/2017 i dt.15.03.2018

Procesmbajtësja
Mervete Berisha

G j y q t a r j a
Elife Uka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.